



# **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

## **Raport Përfundimtar për Auditimin Tematik të ushtruar në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Përmet**

### **Raport Përfundimtar Auditimi Tematik**

**PRILL 2021**



# KONTROLLI I LARTË I SHETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
 RAPORT PËRFUNDIMTAR "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020"  
 NË ZVASHK PËRMET

PËRMBAJTJA			
<b>I.</b>	<b>Përmbledhje Ekzekutive</b>	1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	<b>3</b>
		2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
		3.Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	
<b>II.</b>	<b>Hyrja</b>	1. Objektivi i Auditimit	<b>3-5</b>
		2. Qëllimi i Auditimit	
		3. Identifikimi i çështjes	
		4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
		5. Përgjegjësitë e audituesve	
		6. Kriteret e Vlerësimit	
		7. Standartet e auditimit	
		8. Metodatat e auditimit	
		9. Dokumentimi i auditimit	
<b>III</b>	<b>Përshkrimi i auditimit</b>	<b>5-23</b>	
<b>1</b>	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	<b>5</b>	
<b>2</b>	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	<b>6</b>	
<b>2.1</b>	Hartimi i programit (plani i veprimt). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	<b>6</b>	
<b>2.2</b>	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	<b>7</b>	
<b>2.3</b>	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	<b>7-21</b>	
<b>2.4</b>	Zbatimi i rekomandimeve për shpërbllimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	<b>22</b>	
<b>2.5</b>	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	<b>22-23</b>	
<b>2.6</b>	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.	<b>22</b>	
<b>IV.</b>	<b>Konkluzioni i Auditimit</b>	<b>22</b>	
<b>V.</b>	<b>Lista e dokumenteve të auditimit</b>	<b>23</b>	



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

## I. Përmbledhje Ekzekutive

### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim tematik në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim ZVASHK), Përmet, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, përcjellë me shkresën nr.901/14, datë 19.05.2020. Grupi i auditimit auditoi periudhën nga data 01.11.2016 deri më datë 31.12.2019 “Mbi nivelin e zbatimit të të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2020”.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-konstatim sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmblyës me përfaqësuesit e ZVASHK Përmet.

### 1.2. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet për periudhën 01.01.2016 deri me 31.12.2019, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht ose proces zbatimi, është në nivelin 87%. Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar plotësisht, përveç masave disiplinore, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 30 masa organizative dhe 3 masa për të ardhura të munguara në vlerën 1,729,997 lekë, 4 masa disiplinore, nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*Për përmirësimin e gjendjes nga 30 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 25 rekomandime, 4 rekomandime janë në proces zbatimi, ndërsa 1 rekomandim është ezauruar.*

*Për të ardhura të munguara janë lënë 3 rekomandime në vlerën 1,729,997 lekë (pranuar të gjitha për të cilat janë vendosur kufizimet përkatëse, por nuk është likujduar detyrimi nga asnjë subjekt). Janë lënë 4 masa disiplinore (3 masa “Vërejtje me shkrim” në ZVASHK Përmet dhe 1 masë “Largim nga puna në DVASHK Gjirokastër (ish-ALUIZNI Gjirokastër)”) nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK.*

## II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Përmet (në vijim ZVASHK) “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2020”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative, të ardhura të munguara dhe masave disiplinore.

Sipas Programit të Auditimit, nr.260/4, datë 12.02.2021, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. O. L., Auditues
2. H. M., Auditues

### Titulli

Raport Përfundimtar mbi auditimin tematik, mbi verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2020 të kryer në ZVASHK Përmet.



# KONTROLLI I LARTË I SHETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

## **Marrësi**

ZVASHK Përmët. Titullari i institucionit është z. G. J., Përgjegjës i Zyrës.

## **Objektivat dhe qëllimi i auditimit**

Ky auditim ka objektiv pasqyrimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm të kryer pranë ZVASHK Përmët, si dhe dhënien e opinionit objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në përmirësimin e punës menaxhuese të njësisë publike. Gjithashtu ka si qëllim raportimin mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.

## **Identifikimi i Cështjeve:**

ZVASHK Përmët, si një institucion publik, që është përgjegjës për menaxhimin e fondeve dhe pronës publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, ka detyrimin ligjor që të zbatoj rekomandimet e auditimit të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe të informoj këtë të fundit, mbi nivelin pranimit, zbatimit dhe mos zbatimit të tyre.

## **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me cështjen nën auditim**

Niveli drejtues i ZVASHK Përmët, ka detyrimin ligjor për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, duke përgatitur plan-veprimin për zbatimin e tyre, informacionin mbi nivelin e zbatimit, si dhe duke nxjerrë rast pas rasti Urdhëra, Udhëzime, Rregullore, etj., me qëllim argumentimin e zbatimit të rekomandimeve.

## **Përgjegjësitë e audituesve**

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

## **Kriteret e vlerësimit:**

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

## **Standardet e auditimit**

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Raporti Përfundimtar i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

## **Metodat e auditimit**

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhërave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.



# KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

## **Dokumentimi i rezultateve të Auditimit**

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar do të përgatitet Raporti Përfundimtar i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për ridërgimin e rekomandimeve e për përmirësimin e gjendjes.

## **III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT**

### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**

Ish-ZVRPP Përmet (ZVASHK Përmet) është person juridik, publik jobuxhetor, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Ka për detyrë regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe të gjitha ndryshimeve në lidhje me pasuritë e paluajtshme në bazë të kushteve të përcaktuara nga Ligji nr.33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar. Regjistrimi i pasurive të paluajtshme në rrethin e Përmet drejtohet nga Regjistruesi. Regjistruesi organizon dhe drejton Ish-ZVRPP Përmet (Aktualisht Përgjegjës i ZVASHK Përmet). Veprimtaria e Ish-ZVRPP Përmet mbështetet në parimet e sigurisë juridike, transparencës, ligjshmërisë dhe përparësisë në regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Dispozitat e Ligjit nr.33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar dhe ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” zbatohen për periudhën objekt auditimi për regjistrimin e të gjitha pasurive të paluajtshme që shtrihen brenda territorit (juridiksionit) të Rrethit Përmet, bazuar në aktet e fitimit të pronësisë apo krijimit të të drejtave reale mbi to, sipas kërkesave të paraqitura nga persona juridikë/fizikë, vendas apo të huaj.

### **2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**

#### **1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".**

*1.Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 901/14 prot, datë 19.05.2020, ka dërguar në ZVASHK Përmet (në vartësi të DVASHK Gjirokastër) Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse. Kjo shkresë është protokolluar në ZVASHK Përmet me nr.902 prot., datë 21.05.2020.

- Nga Drejtori i DVASHK Gjirokastër Florjan Taçi është nxjerrë Urdhëri nr.93, datë 27.05.2020 protokolluar me nr. nr.2871, datë 28.05.2020, për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, si dhe ngarkimin me përgjegjësi të ish-Drejtorit V. P. për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

-Ish-Drejtori V. P. ka marrë masa për hartimin e programit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH i protokolluar në ZVASHK Përmet me nr.902/1, datë 08.06.2020 i cili në zbatim të Ligji nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, gërma j, i është dërguar KLSH brenda afatit 20 ditor. Nëpërmjet këtij programi ZVASHK Përmet njofton se ka filluar puna për vendosjen e kufizimeve për pasuritë e trajtuara nga KLSH të cilat kanë rezultuar me probleme. Në këtë program pune janë përcaktuar qartë afatet përkatëse për zbatimin e secilit rekomandim dhe specialistët përkatës.

-Nga Drejtori Gilberto Jaçe nuk janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

## Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr.901/14 prot, datë 19.05.2020 janë lënë 37 rekomandime gjithsej, nga këto: 30 masa organizative dhe 3 masa të ardhura të munguara në vlerën 1,729,997 lekë dhe 4 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*Për përmirësimin e gjendjes nga 30 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 25 rekomandime, 4 rekomandime janë në proces zbatimi, ndërsa 1 rekomandim është ezauruar për shkaqet e argumentuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.*

*Për të ardhura të munguara janë lënë 3 rekomandime në vlerën 1,729,997 lekë (pranuar të gjitha për të cilat janë vendosur kufizimet përkatëse, por nuk është likujduar detyrimi nga asnjë subjekt).*

*Janë lënë 4 masa disiplinore nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre.*

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej në numër	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Ne proces			Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
						Nr. per	Lekë	Nr. per	Në mijë/lek	Nr. Pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Lekë
1.	Masa organizative	30	25	-	4	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Shpërblim demi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Të ardhura të munguara	3	-	-	-	-	1,729,997	-	0	-	-	-	1,729,997
4	Masa disiplinore	4	-	-	-	4	-	-	-	-	-	4	-
	<b>Totali</b>	<b>37</b>	<b>25</b>	<b>-</b>	<b>4</b>	<b>-</b>	<b>1,729,997</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,729,997</b>

**2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësimin në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.**

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësim ligjorë atëherë kjo pikë e programit ezauron me këtë shënim.

**3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Ish-ZVRPP Përmet ka kryer regjistrim fillestar (Njësia e Menaxhimit të Projekteve) dhe ka lëshuar certifikata pronësie në favor të personave privatë, pa dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor si më poshtë:

- Ish-ZVRPP Përmet në 37 raste ka regjistruar në favor të personave privatë më tepër tokë bujqësore se kanë përfituar me titull pronësie.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

- Ish-ZVRPP Përmet në 10 raste ka regjistruar në favor të personave privatë mbi bazën e AMTP-ve të cilat nuk kanë vulë, pra nuk përmbajnë elementët e formës e përmbajtjes.
- Në 1 rast ish-ZVRPP Përmet ka lëshuar certifikatë pronësie në favor të përfituesit të AMTP-së pavarësisht faktit se ai ka hequr dorë nga ajo pronë.

**1.1. Rekomandim:** Përgjegjësi i ZVASHK Përmet të marrë masa, që në bazë të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara (sipas tabelës nr. 6 dhe 7, Kreu VI-Anekse), të kthejë në pronë shtet sipërfaqet e përfituara më tepër se titulli i pronësisë, si dhe rastin kur qytetari ka hequr dorë nga prona, të nxjerrë urdhër kufizimi për 10 rastet e AMTP-ve që nuk përmbajnë elementët e formës e përmbajtjes deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Ish-ZVRPP Përmet, në ZK 2131, fshati Këlcyrë, në 3 raste, ka regjistruar dhe ka lëshuar certifikata pronësie për më tepër tokë bujqësore sesa duhet të përfitonin familjet bujqësore si vijon:

- R. S., ka përfituar 5117 m<sup>2</sup> arë më tepër,
- P. B., ka përfituar 5906 m<sup>2</sup> arë më tepër
- I. B., ka përfituar 8167 m<sup>2</sup> arë më tepër, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.

**2.1. Rekomandim:** Përgjegjësi i ZVASHK Përmet të marrë masa, që në bazë të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në kthimin në pronë shtet sipërfaqeve të përfituara më tepër se titulli i pronësisë nga

- R. S., ka përfituar 5117 m<sup>2</sup> arë më tepër,
- P. B., ka përfituar 5906 m<sup>2</sup> arë më tepër
- I. B., ka përfituar 8167 m<sup>2</sup> arë më tepër, dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Për pasuritë e mësipërme janë vendosur kufizimet sipas urdhërvave përkatës.

**3. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast, në ZK 2131, fshati Këlcyrë, ish-ZVRPP Përmet ka regjistruar dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për sipërfaqen 12000 m<sup>2</sup> arë të dhënë sipas AMTP nr.3589/1, datë 15.08.2017. Kjo AMTP nuk është nxjerrë në zbatim të procedurës ligjore të përcaktuar në Ligjin nr.171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar, si dhe nuk është në formën dhe formatin e përcaktuar në VKM Nr. 994, datë 09.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, i ndryshuar.

***Si konkluzion,*** AMTP nr.3589/1, datë 15.08.2017 nuk duhet të ishte lëshuar nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë dhe nuk duhet të ishte regjistruar nga ish-ZVRPP Përmet.

**3.1. Rekomandim:** Përgjegjësi i ZVASHK Përmet të marrë masa, që në bazë të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në kthimin në pronë shtet sipërfaqeve të përfituara 12000 m<sup>2</sup> arë sipas AMTP nr.3589/1, datë 15.08.2017 dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimit i procedurave të lejeve të legalizimit rezultoi se:

- në 2 raste për pasuritë nr. 514/2, ZK 2057 dhe nr. 432/1, ZK 3524, nga verifikimi i hartës dixhitale nëpërmjet portalit ASIG, rezultoi se objektet e legalizuar ndodhen brenda zonës së mbrojtur Hotovë-Dangëlli, shpallur me VKM nr.1631 datë 17.12.2008, Kategoria II IUCN: Park Kombëtar. Ndërtimi pa leje nuk duhet të legalizohej dhe ish-ZVRPP Përmet nuk duhet të kishte



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

kryer regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës të pronësisë për shkak se ndërtimi është ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen kategorikisht ndërtimet për qëllime banimi. Këto veprime të kryera deri në 04.05.2017 bien në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 6, pika b dhe dh, i cili përcakton se në zonat e mbrojtura të Kategorisë II përsa i përket ngritjes dhe funksionimit të objekteve lejohet vetëm për qëllime mbrojtjeje dhe ushtarake, por vetëm pas paisjes me leje mjedisi.

- në 2 raste për pasuritë nr.26/13, ZK 2917 dhe nr.118-ND, ZK 2073, nga verifikimi i hartës dixhitale nëpërmjet portalit ASIG, rezultoi se objektet e legalizuar ndodhen në një distancë prej 36 m dhe 63 m nga shtrati i Lumit Vjosë.

**4.1. Rekomandim:** Drejtori i DVASHK Përmet të marrë masa bazuar në nenin 27 të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, duke vendosur kufizimin për 4 pasuritë e trajtuara më sipër, si dhe të njoftojë DRZM Gjirokastër, AKZM Tiranë dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në lidhje me regjistrimin e objekteve të legalizuara në zonën e mbrojtur të Hotovë-Dangëlli dhe pranë lumit të Vjosës dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

**5. Gjetje nga auditimi:** Në Zk 2917, në KPP volum 13, faqe 171, me referencë nr. 09925, datë 22.08.2017, sipas urdhrit me nr.1319/1, datë 22.08.2017 të regjistruarit është regjistruar pasuria nr. 13/100 me sipërfaqe 24.3m<sup>2</sup> truall dhe 24.3m<sup>2</sup> ndërtesë. Akti i kolaudimit datë 30.10.1999 rezultoi se është fotokopje e njehsuar nga Bashkia Përmet ndërsa nënshkrimet e sipërmarrësit dhe kolaudatorit janë vendosur më vonë sepse janë më bojë të njomë mbi fotokopjen e vënë në dispozicion. Për më tepër, mungon kontrata e marrëdhënies me truallin. Ish-regjistruari në kundërshtim me Udhëzim Nr.1, datë 13.4.2016, “Për caktimin e kriterëve e të procedurave për regjistrimin e lejes së ndërtimit dhe akteve noteriale të lidhura për zhvillimin, në cilësinë e investitorit e të pronarëve të truallit apo blerësve/porositësve të njësive individuale, të objektit në fazën e karabinasë dhe të objektit të përfunduar”, nuk ka nxjerrë urdhër për vendosjen e kufizimit në seksionin “E” të kartelës deri në zgjidhjen e marrëdhënieve me truallin apo paraqitjen e kontratës së marrëdhënieve me truallin që listohet në shkresën nr. 995 prot, datë 30.06.2017 të Bashkisë Përmet e dërguar në ish-ZVRPP Përmet, por që mungon në referencën e vënë në dispozicion.

**5.1. Rekomandim:** Përgjegjësi i ZVASHK Përmet të marrë masa, në bazë të nenit 27, 43 dhe 56 të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara: të vendosë masë kufizimi për pasurinë pasuria nr.13/100 me sipërfaqe 24.3m<sup>2</sup> truall dhe 24.3m<sup>2</sup> ndërtesë, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për marrëdhëniet me truallin dhe aktin e kolaudimit origjinal dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

**6. Gjetje nga auditimi:** Në ish-ZVRPP Përmet, me referencë nr. 9653, datë 26.10.2016 është bërë regjistrimi fillestar i pronës nga Njësia e Menaxhimit të Projekteve duke regjistruar në KPP volum 27, faqe 161, pasurinë nr.15/9+1-3 me sipërfaqe 18.73 m<sup>2</sup> “Shtesë 1 kat, banesë individuale”. Në praktikën e vënë në dispozicion mungon akti i kolaudimit si një dokument i detyrueshëm për konfirmimin e kontrollit i cili vërteton zbatimin apo jo të projektit dhe kondicioneve urbane të ndërtimit sipas lejes përkatëse. Ish-regjistruari duhet të kishte nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor. Për sa më lartë është vepruar në pajtueshmëri me nenin 46 dhe 59 të Ligjit nr.33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar dhe pikën 24/c të Udhëzim Nr.1, datë 13.04.2016, “Për caktimin e kriterëve e të procedurave për regjistrimin e lejes së ndërtimit dhe akteve noteriale të lidhura për





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

zhvillimin, në cilësinë e investitorit e të pronarëve të truallit apo blerësve/porositësve të njëjve individuale, të objektit në fazën e karabinasë dhe të objektit të përfunduar”.

**6.1. Rekomandim:** Përgjegjësi i ZVASHK Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27, 43 dhe 56 të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të vendosë masë kufizimi për pasurinë nr.15/9+1-3 me sipërfaqe 18.73 m<sup>2</sup> “Shtesë 1 kat, banesë individuale” deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

**7. Gjetje nga auditimi:** Me referencë nr.004, datë 06.09.2006, në ZK1014, fshati Alipostivan, në KPP vol.2 faqe 88, është regjistruar pas. nr.194 me sipërfaqe 2120000 m<sup>2</sup> pyll, sipas projekt-vendimit të ish-KKKP nr.65, datë 21.12.2005 për kthim prone. Sipas referencës nr.003, datë 06.09.2006 është ndryshuar zëri kadastral i sipërfaqes 36175m<sup>2</sup> (pasuri nr.194) nga “Përrua” në “Pyll”. Nga krahasimi i të dy planrilevimeve të përgatitur nga topografi i licensuar, ai i datë 28.07.2006 dhe datë 30.07.2006 rezulton se në planrilevimin e datës 30.07.2006 (të ndodhur në referencë nr.004) nuk është pasqyruar përroi me sipërfaqe 36175 m<sup>2</sup>, që është pasqyruar në plan rilevimin e datës 28.07.2006, por është fshirë me qëllim kalimin e përroit në favor të privatit duke e pasqyruar fiktivisht si sipërfaqe pyjore. Kjo bie në kontradiktë me atë çfarë ai vetë shkruan që “pasuria nr.194 është e regjistruar përrua brenda pyllit”, pra që përroi ndodhet në brendësi të pyllit.

-Në kuptimin e nenit 3 të Ligjit nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, i ndryshuar, burimet ujore (lumenjtë, përrenjtë etj) përbëjnë pasuri publike të patjetërsueshme dhe të paparashkrueshme dhe mbrohen nga konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Parlamenti i RSH dhe në kuptimin e nenit 7 të Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004“Për kthimin dhe kompensimin” klasifikohen si “prona që nuk kthehen” në asnjë rast.

Pasuria nr.194, vol.2 faqe 88 e cila sipas referencës nr.003 është ndryshuar sipërfaqja nga 36175 m<sup>2</sup> e llojit “Përrua” në sipërfaqe 2 120 000 m<sup>2</sup> të llojit “Pyll” është ndarë si më poshtë:

- KPP vol.2, faqe 120, pas.nr.194/1 me sipërfaqe 524 000 m<sup>2</sup>
- KPP vol.2, faqe 121, pas.nr.194/2 me sipërfaqe 511 000 m<sup>2</sup>
- KPP vol.2, faqe 137, pas.nr.194/6 me sipërfaqe 127 750 m<sup>2</sup> pyll
- KPP vol.2, faqe 138, pas.nr.194/7 me sipërfaqe 127 750 m<sup>2</sup> pyll
- KPP vol.2, faqe 139, pas.nr.194/8 me sipërfaqe 127 750 m<sup>2</sup> pyll
- KPP vol.2, faqe 140, pas.nr.194/9 me sipërfaqe 126 750 m<sup>2</sup> pyll
- KPP vol.2, faqe 141, pas.nr.194/10 me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup> pyll
- KPP vol.2, faqe 123, pas.nr.194/4 me sipërfaqe 439300 m<sup>2</sup> pyll
- KPP vol.2, faqe 124, pas.nr.194/5 me sipërfaqe 134000 m<sup>2</sup> pyll.

**7.1. Rekomandim:** Përgjegjësi i ZVASHK Përmet, në zbatim të nenit 27 dhe 46 të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, për shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr.194/1, nr.194/2, nr.194/4, nr.194/5, nr.194/6, nr.194/7, nr.194/8, nr.194/9, nr.194/10 të regjistruara në ZK1014, fshati Alipostivan, deri në kthimin e sipërfaqes 36175m<sup>2</sup> në gjendjen e mëparshme, pra në zërin kadastral “Përrua” me sipërfaqe 36175m<sup>2</sup>, pronë “Shtet” dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

**8. Gjetje nga auditimi:** Me Referencë nr.04550, datë 18.09.2006, në ZK2917, vol. 11, faqe 220, është regjistruar pasuria nr.9/67 me sipërfaqe 665 m<sup>2</sup> truall dhe 161 m<sup>2</sup> ndërtim.

-Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se mungon leja e ndërtimit të objektit apo akti i njoftunisë nr.4 i përmendur në notën e transkriptimit sipas të cilit bazohet “zotnimi i kësaj shtëpie (trualli) dhe kopshtit”. Ky është veprim në papajtueshmëri me pikën 16.4/b dhe d të rregullores



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

nr.184, datë 08.04.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, e ndryshuar.

**8.1. Rekomandim:** Përgjegjësi i ZVASHK Përmet, në zbatim të nenit 27 dhe 46 të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, për shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.9/67 të regjistruar në ZK 2917, qyteti Përmet, deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur tekniko-ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

**9. Gjetje nga auditimi:** Në 4 raste ish-ZVRPP Përmet, ka vijuar regjistrimin e pasurive nr. 23/43+1-5, vol. 3, fq. 183, zk. 2917, në pronësi të V. dhe H. S., nr. 25/80+1-5, vol. 15, fq. 183, zk. 2917, në pronësi të F. P. L., nr. 23/61+1-5, vol. 28, fq. 28, zk. 2917, në pronësi të M. dhe M. T. dhe nr. 23/14+2-4, vol. 8, fq.164, zk. 2917, në pronësi të K. M., sipas kontratave të shitjes nga EKB, me mangësi në dokumentacion pasi nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Noterial dhe nuk është plotësuar *shtojca 2*, në dosje nuk administrohet gjenplani dhe kontrata e bashkëpronësisë si dokumente që shërbejnë për regjistrimin e pallatit, nuk administrohet certifikata familjare që tregon gjendjen familjare datë 01.12.1992, në kundërshtim me pikën 8.4, Kreu IV të Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, pikën 4, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”.

**9.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasurit nr. 23/43+1-5, vol. 3, fq. 183, zk. 2917, në pronësi të V. dhe H. S., nr. 25/80+1-5, vol. 15, fq. 183, zk. 2917, në pronësi të F. P. L., nr. 23/61+1-5, vol. 28, fq. 28, zk. 2917, në pronësi të M. dhe M. T. dhe nr. 23/14+2-4, vol. 8, fq.164, zk. 2917, në pronësi të K. M., deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda datës 31.08.2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Kufizimet janë vendosur sipas urdhërave përkatës.

**10. Gjetje nga auditimi:** Në një rast në regjistrimin e pasurisë nr. 23/43+1-5, vol. 7, fq. 183, zk. 2917-Përmet me sipërfaqe 56.33 m2, në pronësi V. dhe H. S., sipas kontratës shitjes me E. K. B., janë konstatuar mangësi pasi gjenplani dhe planimetria nuk janë dokumente origjinale të lëshuara nga Enti Banesave, por të korigjuara me dorë, çka duhet të detyronte ish-ZVRPP Përmet të refuzonte regjistrimin e praktikës dhe pajisjen me certifikatë pronësie deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor, veprime këto në kundërshtim me pikën 8.4, Kreu IV të Rregullores nr.184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr.7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**10.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasurinë nr. 23/43+1-5, vol. 3, fq. 183, zk. 2917, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda datës 31.08.2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

**11. Gjetje nga auditimi:** Në një rast në regjistrimin e pasurisë nr. 23/14+2-4, vol. 8, fq.164, zk. 2917-Përmet me sipërfaqe 79.12 m2, në pronësi të K. M., sipas kontratës shitjes me Entin



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

Kombëtar të Banesave, janë konstatuar mangësi pasi sipërfaqja e përcaktuar në kontratën e shitjes 71.2 m<sup>2</sup> nuk përputhet me atë të përcaktuar në planimetrin e apartamentit 79.12 m<sup>2</sup>, nga të cilat sipërfaqje shfrytëzimi 65 m<sup>2</sup> dhe sip trualli 22.15 m<sup>2</sup>. Nga ish-ZVRPP Përmet nuk duhet të procedohej me regjistrimin e pasurisë pasi kontrata e shitjes e cila përbën titull pronësie ka pasaktësi në sipërfaqe dhe regjistrimi sipërfaqes prej 7.92 m<sup>2</sup> (79.12-71.2), nuk është e justifikuar me dokumentacion ligjor, veprime këto në kundërshtim me pikën 8.4, Kreu IV të Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**11.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasurin nr. 23/14+2-4, vol. 8, fq.164, zk. 2917, në pronësi të K. M., deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda datës 31.08.2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

**12. Gjetje nga auditimi:** Në 3 raste ish-ZVRPP Përmet, ka vijuar regjistrimin e pasurive nr. 23/165-ND, vol. 27, fq. 241, zk. 2917-Përmet Qytet, në pronësi të Anthi Shehut, nr. 6/17-ND, vol. 8, fq. 49, zk. 2132-Këlcyrë, në pronësi të Th. T. K., nr. 21/470-ND, vol. 27, fq. 243, zk. 2917-Përmet Qytet, në pronësi të J. S. S., sipas lejeve të ndërtimit, me mangësi në dokumentacion pasi nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes dhe nuk janë plotësuar shtojca 2 dhe 3, mungon deklarata e përputhshmërisë bashkëlidhur Lejes së Përdorimit, e cila kofirmon kryerjen e punimeve në përputhje me normat standarde të sigurisë në fuqi, nuk është bërë shënimi në lidhje me marrëdhëniet me truallin në seksionin përkatës në kartelën e pasurisë, veprime këto në papajtueshmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pikën 2 neni 42 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

**12.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që të vlerësojë gjendjen juridiko-tekniko dhe kthimin e ligjshmërisë të regjistrimit të pasurive nr. 23/165-ND, vol. 27, fq. 241, zk. 2917-Përmet Qytet, në pronësi të A. Sh., nr. 6/17-ND, vol. 8, fq. 49, zk. 2132-Këlcyrë, në pronësi të Th. T. K., nr. 21/470-ND, vol. 27, fq. 243, zk. 2917-Përmet Qytet, në pronësi të J. S. S. të përfituara sipas lejeve të ndërtimit. Për çdo regjistrim të pasurive që vijnë nga praktika e lejeve të ndërtimit, të verifikohet plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të nevojshëm për regjistrim në përputhje me përcaktimet ligjore.

*Menjëherë e në vijimësi*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Kufizimet janë vendosur sipas urdhërave përkatës.

**13. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast ish-ZVRPP Përmet, ka vijuar me regjistrimin e pasurisë nr. 6/17-ND, vol. 8, fq. 49, zk. 2132-Këlcyrë, në pronësi të Th.T. K., sipas lejes së ndërtimit, me mangësi në dokumentacion pasi nga verifikimi i marrëdhënieve me truallin rezulton se për pasurin truall nr. 6/20, vol. 6, fq.100, zk. 2132-Këlcyrë, me sip. 3269 m<sup>2</sup>, e llojit shesh, hapur në kartela sipas LN 2013, në pronësi shtet, pa lëshuar certifikatë pronësie, në seksionin Përshkrimi veçantë ka shënimin “VKM nr.530, datë 01.05.2008, me nr.45 i listës së inventarit parcela nr. 6”, ndërsa në seksionin D sipas Ref.1861, datë 13.05.2016 ka shënimin “I jepet në administrim Bashkisë Këlcyrë”, por nuk është bërë aplikim nga Bashkia Këlcyrë për regjistrimin e VKM si dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për pasojë kontrata e shitjes me Bashkinë Këlcyrë datë 07.06.2004, për truallin nuk është e rregullt pasi nuk është e regjistruar në ZVRPP, nuk është bërë me akt-noterial,



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

gjithashtu trualli në pronësi të Bashkisë nuk është pajisur me certifikatë pronësie, veprime këto që bien në kundërshtim me Nenin 46, të Ligjit nr.33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, pika 5 të UKM nr.2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” dhe Udhëzim Nr. 3, datë 03.10.2012.

**13.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurin nr. 6/17-ND, vol. 8, fq. 49, zk. 2132-Këlcyrë, në pronësi të Thimi Taqë Kosta deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda datës 31.08.2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

**14. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast në regjistrimin e pasurisë nr.531/1 -ND, vol.7, fq.60, zk.2057-Kaludh, Leje Legalizimi nr.121841, datë 20.01.2019, në pronësi të L. Dh. S., nga verifikimi i marrëdhënies me truallin, rezulton se AMTP që ka shërbyer për regjistrimin e truallit nuk plotëson elementet e formës dhe përmbajtjes pasi nuk përmban nënshkrimin e Kryetarit të Komisionit të Tokës në Fshat, në kundërshtim me përcaktimet e Kodit të Procedurës Administrative, viti 1999, Neni 116- Aktet administrative absolutisht të pavlefshme, nenin 49 të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Vendimi Nr.390, datë 06.08.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”.

**14.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasurin nr.531, vol. 6, fq. 200, zk. 2057- Kaludh, në pronësi të L. Dh. S. deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda datës 31.08.2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

**15. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast në regjistrimin e pasurisë nr.44/43, vol.3, fq.28, zk.1589-N.B Përmet 2, në pronësi të K. J. R. sipas lejes së legalizimit, nga verifikimi i marrëdhënies me truallin, regjistrimeve të kryera në kartelë sipas AMTP nr.5342 dhe listës printim III rezultoi se shtetasi K. J. R. ka përfituar më shumë se Akti sipërfaqen 617 m<sup>2</sup>, sa vepruar në kundërshtim me ligjin 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar, Ligjin nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, Ligjin nr.8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, me pikën 2 neni 3, të ligjit nr.9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe pikën 2, të VKM-së nr.255 “Për Kriteret e ndarjes së tokës”.

**15.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasurit nr. 20/2, vol. 1, fq. 168, zk. 1589, nr. 43/2, vol. 2, fq. 37, zk. 1589 dhe nr. 44/24, vol. 2, fq. 76, zk. 1589, deri në veçimin në shtet të sipërfaqes tepër prej 617 m<sup>2</sup> të përfituar padrejtësisht nga regjistrimi i AMTP dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda datës 31.08.2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

**16. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast në regjistrimin e pasurisë nr. 478-ND, vol. 7, fq. 56, zk. 2057-Permet/Kaludh, në pronësi të S. M. P., sipas lejes së legalizimit, nga verifikimi i marrëdhënies me truallin, regjistrimeve të kryera në kartelë sipas AMTP nr. 2938 dhe listës printim III rezultoi se ka përfituar sipas AMTP 13450 m<sup>2</sup>, nga këto 13250 m<sup>2</sup> arë, 250 m<sup>2</sup> truall, sipas matjeve faktike



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

në terren ka në total 14521 m<sup>2</sup> nga këto 14336 m<sup>2</sup> arë, 185 truall sipas Listave 0001, ndërkohë që vetëm pasuria nr.478, vol.2, fq.228, zk.2057, Kaludh, me sip. 7753 m<sup>2</sup>, regjistruar në datë 05.05.2003, është pajisur me certifikatë pronësie datë 01.08.2006, pra më shumë 753 m<sup>2</sup> se Akti. Nga ZVASHK Përmet nuk është bërë bilanci AMTP- Lista Printim III sipas përcaktimeve të ligjit 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar, Ligjin nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, Ligjit nr.8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, me pikën 2 neni 3, të ligjit nr.9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe pikën 2, të VKM-së nr.255 “Për Kriteret e ndarjes së tokës”.

**16.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në momentin e pajisjes me certifikatë pronësie të shtetasit S. M. P. për pasuritë e tjera, duhet të bëhet bilanci LN-AMTP, duke veçuar në shtet sipërfaqet tepër dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Në vijimësi*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

**17. Gjetje nga auditimi:** Në 12 raste është konstatuar se gentplani që ka shërbyer për lëshimin dhe regjistrimin e lejes së legalizimit është firmosur për 3 pozicione pune nga i njëjti person, konkretisht për Përgjegjës të Sektorit të Hartografisë, për Specialistin e Hartografisë si dhe për pozicionin Përgjegjës të Sektorit të Çështjeve të Pronësisë veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, Urdhrit nr. 37, datë 19.01.2016 “Për miratimin e plan veprimit për shqyrtimin administrative të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje”, pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruesit” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tyre.

**17.1. Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastrë të marrë masa që në çdo rast të hartimit të dokumentacionit tekniko-ligjor që shërben për lëshimin e lejeve të legalizimit, çdo specialist të nënshkruaj dokumentacionin në përputhje me kompetencat dhe detyrat e ngarkuara sipas përcaktimeve ligjore dhe akteve të dala në zbatim të tyre.

*Në vijimësi*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces.

**18. Gjetje nga auditimi:** Në 2 raste në regjistrimin e pasurive nr. 2/14-N, vol. 7, fq. 165, zk. 2972-Piskove, sipas lejes së Legalizimi nr. 16695, datë 29.08.2016, në pronësi të Astrit Mustafa Lumani, nr. 80/79-N, vol. 7, fq. 164, zk. 2972-Piskove, Leje Legalizimi nr. 28038, datë 30.11.2016, në pronësi të B. S. K., në seksionin E të pasurisë nuk është vendosur masa kufizimi deri në miratimin e VKM për parcelën ndërtimore në kundërshtim me përcaktimet e VKM 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”.

**18.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasurit nr. 2/14-N, vol. 7, fq. 165, zk. 2972-Piskove, në pronësi të A. M. L., nr. 80/79-N, vol. 7, fq. 164, zk. 2972-Piskove, në pronësi të B. S. K. deri në miratimin e VKM për parcelën ndërtimore dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar për pasurinë nr. 80/79-N, vol. 7, fq. 164, zk. 2972-Piskove. Ndërsa për paurinë nr. 2/14-N, vol. 7, fq. 165 është miratuar VKM-ja me nr.89, datë 08.02.2017 për parcelën ndërtimore dhe është bërë pagesa për parcelën ndërtimore sipas faturave.

**19. Gjetje nga auditimi:** Në 18 raste, legalizimi dhe regjistrimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit e regjistrimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre, pasi:

- Në 11 raste me sipërfaqe prej 1700.7 m<sup>2</sup>, për lejet e legalizimit nr. 15745, datë 21.04.2016, pasuria nr. 44/ 43, vol. 3, fq. 28, zk. 1589-N.B Përmet 2, nr. 31869, datë 19.04.2017, pasuria nr. 51-ND, vol. 3, fq. 213, zk. 2946-N.B Petran, nr. 16571, datë 29.12.2016, pasuria nr. 50-ND, vol. 9, fq. 158, zk. 1356-Çarçovë, pasuria nr. 195/4, vol. 4, fq. 94, zk. 2850, Leje Legalizimi nr. 29138, datë 28.12.2016, pasuria nr. 201/3, vol. 4, fq. 84, zk. 1292-Bual, Leje Legalizimi nr. 15956, datë 29.12.2015, pasuria nr. 163/48, vol. 3, fq. 95, zk. 3153-Rapcke, Leje Legalizimi nr. 15839, datë 22.09.2015, pasuria nr. 34/4-ND, vol. 6, fq. 95, zk. 2348, Leje Legalizimit nr. 17893, datë 31.08.2016, pasuria nr. 34/3-ND, vol. 6, fq. 94, zk. 2348, Leje Legalizimi nr. 18075, datë 31.08.2016, pasuria nr. 34/3, vol. 6, fq.82, zk. 2348-Kutal, leje legalizimit nr. 16556, datë 31.08.2016, pasuria nr. 141/43, vol. 3, fq.109, zk. 1231-Bodar, Leje Legalizimi nr. 15839, datë 27.01.2018, pasuria nr. 236/11, vol. 2, fq. 245, zk. 2419-Leshice, Leje Legalizimi nr. 16182, datë 09.01.2016, sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Pyll, P.F, kullotë”. Pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimit e zonave informale” i ndryshuar gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Trull” pa dokumentacion ligjor.

- Në 2 raste në regjistrimin e lejeve të legalizimit nr.31869, datë 19.04.2017, pasuria nr.51-ND, vol.3, fq.213, zk.2946-N.B Petran, nr.30632, datë 22.02.2015, pasuria nr.478-ND, vol.7, fq.56, zk.2057-Permet/ Kaludh, nga verifikimi imazheve rezulton se objektet janë ndërtuar brenda zonës së mbrojtur Bredhi i Hotovës-Dangëlli, miratuar si zonë e mbrojtur me VKM nr. 1631, datë 17.12.2008 “Për shpalljen “Park Kombëtar” të ekosistemit natyror Bredhi i Hotovës-Dangëlli me sipërfaqe të zgjeruar”, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002, është shfuqizuar nga ligji nr.81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 16, “Parku kombëtar” (kategoria II), pika 2, germa “a” dhe neni 33, VKM nr.1631, datë 17.12.2008 “Për shpalljen “Park Kombëtar” të ekosistemit natyror Bredhi i Hotovës-Dangëlli me sipërfaqe të zgjeruar”, pika 4, germa “ç”, VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, Kreu II, pika 2, germa “ë”, Ligjin nr.33/2012 datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 49.

- Në 1 rast në regjistrimin e pasurisë nr. 6/179, vol. 8, fq. 45, zk. 2132-Këlcyrë, sipas lejes së legalizimit, nga verifikimi imazheve nga geoportali asig.gov.al rezulton se objekti informal është ndërtuar ngjitur me rrugën kryesore dhe mbi trotuare, duke mos verifikuar përcaktimet e VKM nr.280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, pika 3 dhe pika 4/8/1, Ligjin nr. 33/2012 datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, neni 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara si dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012.

- Në 2 raste, për nr. 546-ND, vol. 7, fq. 50, zk. 2132-Permet, leje legalizimi nr. 17789, datë 06.12.2016, është kryer legalizimi i objekteve informal të ndërtuar në buzë të lumit Vjosë, pa respektuar distancat nga brigjet dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion i justifikues për këtë qëllim. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar, Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5, neni 4, pika 5 ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” Kreu III, pika 2, germa “h”, pika 3, pika 4, germë “e”.

**19.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet në bashkëpunim me DVASHK Gjirokastër, të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurit e regjistruara sipas lejeve të legalizimit si dhe të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda datës 31.08.2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar, pasi janë vendosur kufizimet sipas urdhërit nr.15, datë 07.04.2021 për pasurinë nr. 50-ND, vol. 9, fq. 158, zk. 1356-Çarçovë, dhe sipas urdhërit nr.14, datë 07.04.2021 për pasuri nr.34/3, vol. 6, fq.82, zk. 2348-Kutal. Urdhërat e mësipërm të vendosjes së kufizimeve janë përcjellë elektronikisht nga subjekti i audituar me komentet përkatëse.

**20. Gjetje nga auditimi:** Ish-ZVRPP Përmet, në 1 rast ka regjistruar pasurinë nr. 13/51, vol. 19, fq. 143, zk.2917-Përmet, me mangësi në dokumentacion, nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes dhe nuk është plotësuar shtojca 2, pasi në dosje nuk administrohet konfirmimi zyrtar i dhënë nga institucioni shtetëror që ka në pronësi apo administron pasurinë kufitare nr. 13/236 e llojit rrugë, nuk administrohet dokumentacioni nga arkivi teknik i ndërtimit, që pasqyron hartografisht gjendjen e pasurisë që pretendohet, gjithashtu sipas kërkesës së bërë dhe plan rievimit sipërfaqja e truallit është 90 m<sup>2</sup>, ndërkohë sip. ndërtimi është 61.3 m<sup>2</sup>, duke mos u përputhur me sipërfaqen e regjistruar dhe të certifikuar, në kundërshtim me kërkesat pikës 4, 5 dhe 6 të VKM Nr.745, datë 24.10.2012 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, pikën 4, të UKM nr.2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”, dhe nenin 25/b të Ligjit nr.33/2012 datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**20.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurin nr. 13/51, vol. 19, fq. 143, zk.2917-Përmet, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

**21. Gjetje nga auditimi:** Ish-ZVRPP Përmet, në 1 rast ka regjistruar pasurin nr.9/76, vol. 19, fq. 168, zk. 2917-Përmet, me mangësi në dokumentacion, nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes dhe nuk është plotësuar shtojca 2, pasi në dosje nuk administrohet konfirmimi



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

zyrtar i dhënë nga institucioni shtetëror që ka në pronësi apo administron pasurinë kufitare nr. 9/78 e llojit trotuare në pronësi shtet, nuk administrohet dokumentacioni nga arkivi teknik i ndërtimit, që pasqyron hartografisht gjendjen e pasurisë që pretendohet, gjithashtu kërkesë për regjistrimin e pasurisë datë 25.04.2018, e pa firmosur nga kërkuesi, deklaratë e pronarëve kufitarë datë 19.04.2018, rezulton më parë në kohë nga data kur është bërë kërkesa për regjistrim, veprime këto në kundërshtim me kërkesat pikës 4, 5 dhe 6 të VKM Nr. 745, datë 24.10.2012 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, pikën 4, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruarit”, dhe nenin 25/b të Ligjit nr. 33/2012 datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**21.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurin nr. 9/76, vol. 19, fq. 168, zk. 2917-Përmet, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

**22. Gjetje nga auditimi:** Ish-ZVRPP Përmet, në 1 rast ka regjistruar pasurin nr. 14/121, vol. 19, fq. 74, zk. 2917-Përmet, me mangësi në dokumentacion, nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes dhe nuk është plotësuar shtojca 2, pasi në dosje mungon kërkesa e bërë nga personi për regjistrimin e pronës sipas formularit standard të parashikuar si dhe Vendimi për regjistrimin e pasurisë, nuk administrohet dokumentacioni nga arkivi teknik i ndërtimit, që pasqyron hartografisht gjendjen e pasurisë që pretendohet, veprime këto në kundërshtim me kërkesat pikës 4, 5 dhe 6 të VKM Nr. 745, datë 24.10.2012 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, pikën 4, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruarit”, dhe nenin 25/b të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**22.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurin nr. 14/121, vol. 19, fq. 74, zk. 2917-Përmet, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

**23. Gjetje nga auditimi:** Ish-ZVRPP Përmet, në 1 rast ka regjistruar pasurinë nr. 13/76, vol. 9, fq. 210, zk. 2917-Përmet, me mangësi në dokumentacion, nuk janë verifikuar elementët e formës dhe të përmbajtjes dhe nuk është plotësuar shtojca 2, pasi në dosje nuk administrohet dokumentacioni nga arkivi teknik i ndërtimit, që pasqyron hartografisht gjendjen e pasurisë që pretendohet si dhe mungon akti shitblerjes nr. 243, datë 19.10.1960, kërkesa për regjistrim pa datë; deklaratë personale për pasurit kufitare pa datë, veprime këto në kundërshtim me kërkesat pikës 4, 5 dhe 6 të VKM Nr. 745, datë 24.10.2012 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, pikën 4, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruarit”, dhe nenin 25/b të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

**23.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurin nr. 13/76, vol. 9, fq. 210, zk. 2917-Përmet, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

**24. Gjetje nga auditimi:** Ish-ZVRPP Përmet, në 1 rast ka regjistruar pasurin nr. 6/79, vol. 16, fq. 30, zk. 2917-Përmet, me sipërfaqe 402 m<sup>2</sup> truall dhe 83.65 m<sup>2</sup> ndërtesë, me mangësi në dokumentacion pasi në referencën nr. 4990, datë 27.05.2009 mungon kontrata e dhurimit nr. 292 Rep, Nr. 890 Kol, datë 13.01.1992, ku K. M. i ka dhuruar Th. M. një dhomë ekzistuese që zë një sipërfaqe truall 24 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqen e baces prej 231 m<sup>2</sup> (11m x 21 m), pra në total truallin prej 255 m<sup>2</sup>, nga planvendosja e administruar në dosje rezulton sipërfaqja e truallit 445 m<sup>2</sup> dhe ndërtim sip. 83.65 m<sup>2</sup>, ndërkohë sipas hartave treguese të regjistrimit sipërfaqja e truallit është 402 m<sup>2</sup>, pra ka mospërputhje, mungon titulli i pronësisë për sipërfaqen prej 147 m<sup>2</sup>, mungon konfirmimi zyrtar i dhënë nga institucioni shtetëror që ka në pronësi apo administron pasuritë kufitarë me pasurinë e pretenduar për regjistrim, për pasojë ish-ZVRPP Përmet nuk duhet të vijonte me regjistrimin e pasurisë deri në plotësimin e dokumentacionit veprime këto që bien në kundërshtim me Nenin 24/b, të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i ndryshuar. Me Ref. 9285, datë 05.05.2016, pasuria më sipër ka kaluar në pronësi të R. R. J., sipas kontratës së shitjes nr. 1798 Rep, nr. 669 Kol, datë 01.09.2015, regjistruar në regjistrin hipotekor nr 16-165 dt 01/09/2015. Në kartelë është pasqyruar dhe shënimi sipas LN 2013, ku sip. truall 398 m<sup>2</sup> nga kjo sip ndërtimi 93 m<sup>2</sup> dhe tek përshkrimi i veçantë i pasurisë është përshkruar ka diference dok-fak = 9.35 m<sup>2</sup>. Pra ka një mospërputhje ndërmjet kontratës së shitjes ku sipërfaqja e truallit është 402 m<sup>2</sup> dhe ndërtesa 83.65 m<sup>2</sup>, ndërkohë që sipas LN 2013 sip. truall 398 m<sup>2</sup> nga kjo sip ndërtimi 93m<sup>2</sup>.

**24.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurin nr. 6/79, vol. 16, fq. 30, zk. 2917-Përmet, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe të mos kryejë asnjë veprim mbi pasurin deri në zgjidhjen e konfliktit civil-gjyqësor ndërmjet palëve dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

**25. Gjetje nga auditimi:** Ish-ZVRPP Përmet, në 1 rast ka regjistruar pasurinë nr.13/211, vol.19, fq.126, zk.2917-Përmet, me mangësi në dokumentacion, nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes dhe nuk është plotësuar shtojca 2, pasi plan rilevimi dhe plan vendosja sipërfaqja e truallit është 122 m<sup>2</sup>, ndërkohë sip. ndërtimi është 98 m<sup>2</sup>, duke mos u përputhur me sipërfaqen e regjistruar dhe të certifikuar, pra ish-ZVRPP duhet të kërkonte dorëzimin e planrilevimit të ri në përputhje me regjistrimin e kryer, mungon dokumentacioni nga arkivi teknik i ndërtimit, që pasqyron hartografisht gjendjen e pasurisë që pretendohet, gjithashtu dokumentacioni i paraqitur për pronësinë nuk vërteton titullin e pronësisë dhe origjinën e pronës në kundërshtim me kërkesat e nenit 25/b të Ligjit nr.33/2012 datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si dhe kërkesat e pikës 4 e vijim të VKM Nr. 745, datë 24.10.2012 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”.

**25.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurin nr.13/211, vol.19, fq.126, zk.2917-Përmet, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kthimin e ligjshmërisë.



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

*Brenda muajit Korrik 2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**

**26. Gjetje nga auditimi:** Ish-ZVRPP Përmet nuk ka mbajtur evidencë më vete të proceseve gjyqësore për vitet 2016 dhe 2017, hapjen e dosjeve, ndjekjen dhe ecurin e tyre, nuk është ngarkuar me urdhër të veçantë një person kompetent për ndjekjen e tyre, gjithashtu gjatë periudhës 01.01.2016-31.12.2019 ASHK Përmet ka qenë palë në 42 procese gjyqësore në cilësinë e palës së paditur dhe të palës së tretë, nga të cilat në një rast nuk ka ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit pasi Gjykata ka shpallur të pavlefshëm AMTP dhe është ngarkuar me detyrimin për pagimin e shpenzimeve Bashkia Këlcyrë, pra është kundërshtuar titulli i pronësisë, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet e Nenit 391, 442, 443, 444 të Ligjit nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 45 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**26.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa të menjëhershme të caktojë me urdhër të brendshëm një specialist i cili do të përfaqësojë në vazhdimësi zyrën në proceset gjyqësore, të ndjekë të gjithë shkallët e gjyqësorit duke bërë ankimimet përkatëse si dhe të krijojë database duke evidentuar të gjitha proceset gjyqësore, ecurinë e tyre si dhe hapjen e dosjeve për secilin proces.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe është ezauruar për shkak se nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK Tiranë me shkresë nr.3033 prot., datë 15.02.2021 është përcjellë udhëzimi nr.600, datë 11.02.2021 sipas të cilit kompetencat e ndjekjes së proceseve gjyqësore i ka kaluar përfaqësuesit ligjor të DVASHK Gjirokastër.

**27. Gjetje nga auditimi:** Ish-ZVRPP Përmet nuk ka mbajtur evidencë më vete të ankesave të trajtuara gjatë periudhës 01.01.2016-31.12.2017, afatet e shqyrtimit të tyre, përgjigjet dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre, gjithashtu nuk është ngarkuar me urdhër të veçantë një person kompetent apo një grup specialistësh për shqyrtimin e ankesave, në asnjë nga dokumentet e punës të paraqitura për auditim nuk është adresuar përgjegjësia për shqyrtimin e ankesave, por ato i janë adresuar specialistëve përkatës rast pas rasti. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi dhe rakordimi ndërmjet sektorëve madje duke lënë pa adresuar problematikat e ngritura në ankesat e qytetarëve si dhe zgjidhjen brenda afateve ligjore, konkretisht gjatë periudhës 01.01.2016-31.12.2019, në 10 raste nuk është kthyer përgjigje për ankesat e bëra nga qytetarët apo institucione të ndryshme. Veprimet dhe mosveprimet më sipër bien në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

**27.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet, të marrë masa dhe të caktojë me urdhër një person kompetent për mbajtjen e evidencave të ankesave të trajtuara ndër vite, afatet e shqyrtimit të tyre, përgjigjet dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre, arshivimin e dokumentacionit që faktin kthimin e përgjigjes, të rrisë bashkëpunimin ndërmjet sektorëve duke adresuar problematikat e ngritura në ankesa si dhe dhënien e zgjidhjeve ligjore të problemeve.

*Në vijimësi*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces**.

**28. Gjetje nga auditimi:** Ish-ZVRPP Përmet nuk ka zbatuar procedurat ligjore lidhur me administrimin e dokumentacionit dhe zbatimin e afateve ligjore për kryerjen e shërbimeve të faturuara, ndaj qytetarëve, si vijon:

1. Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara të cilat prej 3 vitesh deri në 31.12.2019 janë 208 praktika në proces dhe 73 praktika me AV, me të ardhura të përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar, mos administrimin në arkivë të dokumentacionit, mbajtjen e



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës ndaj publikut dhe mosfunksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Mekanizmin Financiar dhe Kontrollin”, në mos zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”, neni 24, germa “b” dhe të neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për “Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror” dhe “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjit nr.33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” i ndryshuar, Rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

2. Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet (ish-ZVRPP Përmet), nuk ka hartuar dhe dërguar për miratim nga Kryeregjistruesi, një rregullore të brendshme të Funkcionimit të Administratës, për periudhën e mëparshme dhe për periudhën 01.01.2016- deri 31.12.2019, të bazuar në organikat dhe organigramat e miratuara nga qeveria me urdhrat përkatës, pasi Rregullorja aktuale nr.184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ASHK-s, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit, pra nuk është e përshtatur me kërkesat ligjore aktuale, për rrjedhojë nuk ka një përcaktim të kryerjes së detyrave, lidhur me ushtrimin e kompetencave dhe mbajtjes së përgjegjësive, të secilit specialist sipas sektorëve përkatës, Regjistruesit, lidhur me përgatitjen e evidencave, informacionit në tërësi si dhe sidomos lidhur administrimin e dokumentacionit me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve për mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë dhe sidomos lidhur me evidentimin, raportimin e praktikave në proces, evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësive së zgjatjes dhe shkëljes së afateve, pra mungon Sistemi i Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) sa vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

**28.1. Rekomandim:** Përgjegjësi i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet, të marrë masat për inventarizimin e dokumentacionit, dhe të evadohen aplikimet e 208 praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara, para dhe prej 3 vitesh, deri në 31.12.2019, për të bërë të mundur kryerjen e shërbimit të faturuar, rritjen e integritetit dhe transparencës së punës së Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet ndaj publikut, si dhe të administrohet në arkiv dokumentacioni përkatës i praktikave në proces.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces**.

**28.2. Rekomandim:** Përgjegjësi i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të marrë masa për të hartuar e miratuar Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit të Administratës, e cila do të përcaktojë qartë funksionimin e hallkave e strukturave dhe detyrat e përgjegjësive për çdo punonjës, duke ngritur e forcuar Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB).

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. ZVASHK ka hartuar rregulloren e brendshme sipas rekomandimit të KLSH më datë 30.06.2020

**29. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i praktikave të arkivuara është konstatuar një numër i konsiderueshëm i praktikave të përfunduara dhe që kanë marrë numër reference me vullë të kuqe, por nuk është bërë inventarizimi dhe nuk janë dorëzuar në arkiv që prej 5 vitesh veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren nr.207, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP”.



# KONTROLLI I LARTË I SHITIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

**29.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet, të marrë masa të menjëhershme të ngrejë grup pune për evidentimin e praktikave të përfunduara dhe të pa arkivuara si dhe të bëjë inventarizimin dhe arkivimin e tyre në përputhje me përcaktimet ligjore.

*Brenda datës 31.08.2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

**30. Gjetje nga auditimi:** Ish-ZVRPP Përmet sipas aplikimeve nga kompania “I. E. P.”, me nr. 1103, 1104, 1105, datë 01.11.2018, ka vijuar procedurat e regjistrimit të HEC-ve, Ura e Dashit, Lengarica 3, Gostivisht, sipas lejeve përkatëse të ndërtimit dhe dokumentacionit shoqërues të përcjellë nga Bashkia Përmet, janë hapur 6 kartela pasurie përkatësisht pasuria me nr. 4-Nd, volum 1, fq. 4, zona kadastrale 1463, fshati Delvinë, llojit ndërtesë me sipërfaqe 205 m<sup>2</sup> në pronësi të “Idro Energia Pulita”, pasuria me nr. 2-Nd, volum 1, fq. 2, zona kadastrale 1822, fshati Gostivisht, llojit ndërtesë me sipërfaqe 164.3 m<sup>2</sup>, në pronësi të “I. E. P.”, pasuria me nr. 2-Nd, volum 1, fq. 2, zona kadastrale 1463, fshati Delvinë, llojit ndërtesë, me sipërfaqe 244.4 m<sup>2</sup>, në pronësi të “I. E. P.”, pasuria me nr. 3, volum 1, fq. 3, zona kadastrale 1463, fshati Delvinë, llojit truall, me sipërfaqe 1363.8 m<sup>2</sup> në pronësi shtet, pasuria me nr. 1, volum 1, fq. 1, zona kadastrale 1463, fshati Delvinë, llojit truall, me sipërfaqe 515.7 m<sup>2</sup> në pronësi shtet dhe pasuria me nr. 1, volum 1, fq. 1, zona kadastrale 1822, fshati Gostivisht, llojit truall, me sipërfaqe 663 m<sup>2</sup> në pronësi shtet, por për asnjë prej pasurive nuk është lëshuar certifikatë pronësie.

**30.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bashkëpunim me Bashkinë Përmet, bazuar në aplikimet e bëra nr.1103, datë 01.11.2018, nr.1104, datë 01.11.2018 dhe nr.1103, datë 01.11.2018, dhe dokumentacionit tekniko–ligjor të dorëzuar të pajisë me certifikatë pronësie pasuritë e regjistruara, duke vendosur shënimet përkatëse në kartelat e pasurisë për objektet ndërtesë, për kufizimin e kalimit e të drejtës së pronësisë nga koncesionari tek palët e treta sipas përcaktimeve të kontratës koncesionare.

*Menjëherë*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

**4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik.** Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për shpërblim dëmi ekonomik atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

**5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet.** Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

**1. Gjetje nga auditimi:** Në 5 raste, ish-ZVRPP Përmet ka regjistruar lejet e ndërtimit pa llogaritur dhe pa arkëtuar kamatë vonesën për regjistrimin me vonesë të aktit administrativ në vlerën totale prej 1,413,200 lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për subjektet si më poshtë:

- 1.G. H., ZK2131, fshati Këlcyrë, 300,000 lekë
2. A. Q., ZK 2917, Qytet Përmet, 300,000 lekë



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

3. M. A., ZK 2917, Qytet Përmet, 213,200 lekë
4. L. S., ZK 2073, fshati Kanikol, 300,000 lekë
5. A. M., ZK 2461, Qytet Këlcyre, 300,000 lekë

Ky veprim bie në kundërshtim me nenet 38 dhe 39 të Ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar.

**1.1. Rekomandim:** Regjistruesi i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa, bazuar në nenin 27 të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë e regjistruara si më lart, deri në arkëtimin në favor të shtetit të detyrimeve të përcaktuara në vlerën 1,413,200 lekë dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Menjëherë*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Për pasuritë e mësipërme janë vendosur kufizimet sipas urdhërvave përkatës.

**2. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast ish-ZVRPP Përmet, ka vijuar regjistrimin e pasurisë nr. 6/17-ND, vol. 8, fq. 49, zk. 2132-Këlcyre, në pronësi të Th. T. K., sipas lejes së ndërtimit, me mangësi në dokumentacion pasi nga verifikimi rezulton se leja e përdorimit mban datë 22.11.2012 dhe kërkesa për regjistrim është bërë më datë 17.09.2018, pra më shumë se 30 ditë nga data e daljes së aktit dhe ish-ZVRPP Përmet duhet të mbante kamatëvonesën prej 300,000 lekë para se të regjistronte titullin e pronësisë dhe të lëshonte certifikatën. Mospagimi i detyrimit të kamatëvonesës prej 300,000 lekë përbën të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në po të njëjtën vlerë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar Neni 38- Regjistrimi i detyruar, Neni 39- Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim.

**2.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet të marrë masa që në bazë të nenit 27/b të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurin nr. 6/17-ND, vol. 8, fq. 49, zk. 2132-Këlcyre, në pronësi të Th. T. K. dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej 300,000 lekë që përbën të ardhura të munguara si rezultat i mospagimit të kamatëvonesës në regjistrim dhe kthimin e ligjshmërisë.

*Brenda datës 31.08.2020*

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

**3. Gjetje nga auditimi:** Në 2 raste Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet (ish-ZVRPP Përmet), nuk ka arkëtuar vlerën 16,797 lekë që përbën shkelje të disiplinës financiare me të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit, që vijnë nga mosarkëtimi i të ardhurave nga mos llogaritja e tarifës së taksës ndikimit në infrastrukturë gjatë regjistrimit të lejeve të legalizimit, për:

- Pasurinë nr. 195/4, vol. 4, fq. 94, zk. 2850, Leje Legalizimi nr. 29138, datë 28.12.2016, në pronësi të B. N. Q., për vlerën 16,797 lekë;

Veprimet më sipër bien në kundërshtim me nenin 49-Regjistrimi i objekteve të legalizuara të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, nenin 27, pika “ç” të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar”, si dhe Kreu I, pikën 1, c dhe pika 2 të VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit”.

**3.1. Rekomandim:** Përgjegjësi i Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet, të marrë masa, që në bazë të nenit 27/b, të Ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi deri në arkëtimin e vlerës totale 16,797 lekë dhe kthimin e ligjshmërisë, përkatësisht për:

- Pasurinë nr. 195/4, vol. 4, fq. 94, zk. 2850, Leje Legalizimi nr. 29138, datë 28.12.2016, në pronësi të B. N. Q., për vlerën 16,797 lekë;



# KONTROLLI I LARTË I SHETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”  
NË ZVASHK PËRMET

Brenda datës 31.08.2020

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

**6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.**

Nga verifikimi i korrespondencës me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK rezultoi se nuk është marrë asnjë masë disiplinore për punonjësit të konstatuar si përgjegjës për shkeljet e konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, përkatësisht 3 masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” për punonjësit e ZVASHK Përmet dhe një masë “Largim nga puna” për një punonjës të ish-ALUIZNI Gjirokastër.

## **IV.KONKLZIONI I AUDITIMIT**

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet për periudhën 01.01.2016 deri me 31.12.2019, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht ose proces zbatimi, është në nivelin 87%. Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar plotësisht, përveç masave disiplinore, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 30 masa organizative dhe 3 masa për të ardhura të munguara në vlerën 1,729,997 lekë, 4 masa disiplinore, nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*Për përmirësimin e gjendjes nga 30 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 25 rekomandime, 4 rekomandime janë në proces zbatimi, ndërsa 1 rekomandim është ezauruar.*

*Për të ardhura të munguara janë lënë 3 rekomandime në vlerën 1,729,997 lekë (pranuar të gjitha për të cilat janë vendosur kufizimet përkatëse, por nuk është likujduar detyrimi nga asnjë subjekt). Janë lënë 4 masa disiplinore (3 masa “Vërejtje me shkrim” në ZVASHK Përmet dhe 1 masë “Largim nga puna në DVASHK Gjirokastër (ish-ALUIZNI Gjirokastër)”) nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK.*

## **V. LISTA E DOKUMENTAVE TË AUDITIMIT**

1.Akt-konstatimi nr.1, datë 26.02.2021, mbajtur në ZVASHK Përmet

**Shënim:** Pas hartimit të Projektraportit të auditimit mbi bazën e dokumentave të mësipërme dhe përcjelljes së tij, nga subjekti i audituar janë paraqitur observacionet elektronikisht të cilat janë marrë në konsideratë dhe janë pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

**K kontrolli i Lartë i Shtetit**